



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA HIMARË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 54 prot.

Himarë, më 07.08.2023

**PROCESVERBAL I ZBARDHIUR NGA ORGJINALI MBI ZHVILLIMIN E
MBLEDHJES JASHTË RADHE ,MUAJ GUSHT DATË 07.08.2023**

**Mbledhja jashtë radhe e Këshillit Bashkiak Himarë zhvilluar më datë 07.08.2023,ora
10:30**

1. Në mbledhje marrin pjesë këshilltarët:

Gjergji Iliadhi, Elisabeta Lamaj, Dhimitër Kapaj, Loreta Isufi, Thodhori Foto, Mirka Gjiçali,
MILTO Nika, Aleks Llazari, Silva Burbo, Fuat Mati, Timoleo Gërdhuqi, Lenica Kocani,
Miltiadh Prifti, Afrovita Dhimojani.

2. Mungojnë: Maks Vlashi, Artan Bala, Nikolinë Laska, Thëllëza Kokaveshi, Artionil
Shirokaj, Nertila Husi, Qirjako Mërkuri (pa arsye)

Në mbledhje marrin pjesë të ftuar:

Drejtoritë e drejtorive, administratorët e njësive të Bashkisë Himarë.

Sigurohet mbi 50% pjesëmarrja e këshilltarëve.

Mbledhjen e hap Kryetari i Këshillit Z. Dhimitër Kapaj

Komunikohet këshillit shprehja e ligjshmërisë së vendimeve të muajt Korrik nga Prefektura e
Qarkut Vlorë (sekretarja Elena Memushaj)

3. Miratimi i rendit të ditës.

Kryetari Këshillit:- Jeni dakort me rendin e ditës?

Këshilltarja Silva Burbo:- Kam diçka para se të fillojë mbledhja Z.Kryetar.

Kryetari Këshillit:- Më thuaj.

Në mbledhjen e mëparshme kishim lënë pikën e fundit pa kaluar, pa shqyrtuar, a ishte në rend
të ditës, pika e fundit ku është në rendin e ditës sot, dhe kjo nuk është në përgjegjësinë tuaj por
në përgjegjësinë e këshillit?

Kryetari i Këshillit:- ta kam shpjeguar edhe një herë dhe po ta shpjegoj prapë sot këtu dhe mos ma ngarkoni mua këtë përgjegjësi. Në qoftë se Kryetari i zgjedhur nga votat e Himarës, nëse paraqitet në mbledhje, unë do t'i jap mandatin, atë që i takon, në qoftë se ke një pikë në ligj që ka vendos shteti apo në rregulloren e këshillit që thotë se mandati i jepet Kryetarit të Bashkisë me tel atje ku ndodhet ose online, unë jam dakort të shkoj me këshillin atje ku ndodhet. Nëse jeni dakort me këto pika që ka sot mbledhja vazhdojmë, nëse nuk jeni dakort e lëmë mbledhjen tjetër pikën që juve kërkoni, e lëmë pikë të parë.

Nëse jeni dakort e hedhim në votim rendin e ditës, kemi 3 pika për të shqyrtuar, nëse nuk jeni dakort mos ta hedhim në votim dhe ikim.

Grupi këshilltarëve BF nuk jemi dakort, duam të futet në rendin e ditës kërkesa jonë, të jetë pikë e 4-ërt.

Këshilltarja Afrovita Dhimojani:- ne kërkojmë që kërkesa jonë që kemi bërë të futet në rendin e ditës.

Kryetari i Këshillit:- jo jemi dakort, dhe të fusim pika të tjera, rendi i ditës ka tre pika sepse kështu është rregulli.

Këshilltari Gjergji Iliadhi:- Më falni jam dakort me qytetarët nëse duan të qëndrojnë të rrinë e të dëgjojnë, nëse kanë diçka ta paraqesin te sekretarja me shkrim por jo si u bë në mbledhjen e mëparshme, nuk vijmë këtu për ofendime, ju lutem edhe juve (drejtohet grupit të këshilltarëve të BF) ju lutemi kujdes me retorikën, kush ka diçka nga qytetarët mund të flas ta dëgjojmë, ju kemi respektuar të gjithëve që nga kryetarja e grupit BF e deri tek çdo antarë këshilli. Për pikën që kërkoni nëse është në bazë të ligjit hajde e zbatojmë bashkë, përndryshe nuk e shkel ligjin, kjo pikë është konsumuar, është trajtuar (duartrokitje dhe brohoritje në sallë)

Mbledhja bëhet e zhurshme nga qytetarët në sallë dhe këshilltarët flasin pa leje duke bërë zhurmuesin.

Kryetari i Këshillit :- ju lutem policia bashkiake kush do të flas pa leje nga salla nxirre përjashta.

Brohoritje dhe depate në sallën e mbledhjes.

Këshilltari Fuat Mati:- Kërkon qytetarëve në sallë të ruajnë qetësinë dhe të respektohet rregullorja dhe etika e këshillit. Në mbledhjen e kaluar mos kujtoni se nuk e vumë re që ishte çuar pikë e fundit kërkesa jonë (betimi i Kryetarit). Në mbledhjen e kaluar ne ishim dakort të kalonin pagat dhe ndihmat ekonomike, problem ishte pika e fundit dhe mënyra se si u soll këshilli, nuk mund të çohet një këshilltar nga tavolina pa firmos në procesverbal dhe të largohet nga salla pa u mbyll mbledhja, apo të largohet maxhoranca nga mbledhja. Këto që bëjmë ne në sallë është gabim, duhet të jemi më të përgjegjshëm dhe më serioz. Unë mbështes vendimin që do të marr grupi jonë, le t'na bashkohet kushdo nga grupi i majtë, nëse do të duhet me shkrim çdo kërkesë t'ju paraqesim me shkrim, kemi propozuar kryetaren e grupit tonë Znj. Afrovita Dhimojani. Nuk do të iki asnjë këshilltar pa firmosur në protokoll. Znj. sekretare nuk duhet të lërë asnjë hapsire në protokoll.

Këshilltarja ,Afrovita Dhimojani:- Të jeni të bindur se këta qytetarët që reagojnë kështu, reagojnë se nga ky këshill kuptojnë se e trajtojnë situatën sikur është tepër normale e cila nuk

është aspak normale, sot kryetari i Bashkisë ndodhet në paraburgim dhe ne si këshill e vetmja gjë që kemi kërkuar, nuk po ua lëmë përgjegjësitë individuale se përgjegjësitë i kemi kolektive në këtë këshill por duke parë qëndrimet tuaja në këto dy mbledhje mos u habitni me qytetarët, sepse qytetarët si të majtë si të djathtë na votojnë të mbrojmë interesat e tyre, të lexojmë votat e tyre, në lidhje me reagimin e qytetarëve nëse ky këshill nuk funksionon sipas rregullores gjendja do të përkeqësohet sepse ligji me dashje apo dashje është shkelur. Ne nuk jemi politikë këtu, jemi individë që mbrojmë interesat e qytetarëve.

Replika dhe kundër-replika mes këshilltares dhe kryetarit të këshillit.

Lidhur me kërkesën tonë për bërjen e betimit kemi propozuar të krijojmë të gjitha mundësit ligjore, kemi kërkuar ta votojmë si këshill të votohet kërkesa jonë, nëse bëhet apo nuk bëhet e vendosin organe të tjera. Qytetarët ndaj reagojnë me këtë sjellje sepse silleni sikur nuk ka ndodh asgjë, sikur nuk kemi kryetar Bashkie, sikur jemi normal ... e të tjerë.

Kryetari i Këshillit:- A mbarove?

Zonja kryetare meqënëse jeton në Tiranë dhe je juriste mund t'ua shpjegosh të gjithëve dhe ne jemi dakort nëse ka një pikë e ligjit që thotë për betimin, të betohet atje ku ndodhet. Këtu jemi të zbatojmë rregulloren dhe ligjin.

Këshilltari Multiadh Prifti:- Mund t'më thuash kush i fitojë zgjedhet në Bashkinë Himarë në dt 14 maj, 2023?

Kryetari këshillit:- Fredi Beleri .Ju lutem i lini këto! Më jepni një pikë të ligjit të bazohemi.

Këshilltarët e BF flasin pa leje , bëhet e zhurmshme mbledhja.

Miratohet rendi i ditës me dakortësinë e kërkesës së grupit të këshilltarëve të BF për kërkesën e kryetarit mbi bërjen e betimit të Kryetarit Z.Fredi Beleri në mbledhjen e ardhshme të jetë pikë e parë e rendit të ditës.

Miratohet rendi ditës.

Pika e parë e rendit të ditës.

Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit "Për miratimin e ndryshimeve buxhetore mbi efektin e rritjes së pagave".

Këshilltari Fuat Mati:- Nëse ne nuk e miratojmë , bëhet shtimi i pagave?

Kryetari i këshillit:- është vendim me VKM, doni sqarim nga drejtori i financës, le ta dëgjojmë.

Shpjegon drejtori i financës Z.Laert Mezani.

Përshëndetje të gjithëve. Informacionet janë të njëjta si te projektvendimi që u kam paraqitur këshilltarëve .Ndryshimet buxhetore prekin rritjen e pagave të punonjësve, Për këto fonde kemi 19,305,820 lekë, kjo vlerë do të përballlet nga fondi specifik nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, nga fondi i kontigjencave dhe fondi rezervë. Ndryshimi i pagave nuk ka sjell ndryshime rrënjësore në buxhet.

Këshilltarja Afrovi Dhimojani:- Rritja e pagave që është në vlerat 1%, 2% është shtesa për vjetërsi?

Ndryshon buxheti nga rritja e pagave?

Këshilltarja Afrovita Dhimojani:-Duhet protokolluar kryetarët e grupeve të Këshillit Bashkiak. **Kryetarët e grupeve: Kryetare e grupit Bashkë Fitojmë,Afrovita Dhimojani.**

Kryetar i grupit Partia Socialiste,Mirka Gjiçali.

Miratohet nga këshilltarët kryesia e grupeve të Këshillit Bashkiak Himarë 2023.

Pika 1 e rendit të ditës.

Shqyrtimi i projektvendimit për rregulloren e Këshillit Bashkiak Himarë.

Kryetari Këshillit:-Kjo rregullore ka për qëllim të përcaktoj rregullat dhe procedurat qe do të ndiqen në këshill.

Afrovita Dhimojani:- Me sa pashë rregullorja është e përshtatur gati si çdo këshill bashkiak,pika 1 e nenit 9 ka nevoj për ndryshim dhe neni 32 ka nevojë për ndryshim.

Kryetari Këshillit:-jeni dakort për ndryshimet? Po këshilltarët.

Këshilltarja Silva Burbo: Me leje ? Tek rregulloret dhe strategjitë që voton këshilli ,shtojza 17 rregullore e Këshillit Bashkiak,pse nuk zbatohet,për plazhet a ka ndonjë plan përcaktimi,strategjie për turizmin?

Këshilltarja ,Loreta Isufi: - Me leje kryetar,t'i përgjigjem unë? Po :- kryetari .

Të gjitha subjektet monitorohen nga Ministria e Turizmit dhe nuk është në kopetencën e këshillit dhe Bashkisë.

Këshilltari ,Fuat Mati:-Zhvillimi turistikë është bërë në bazë të infrastrukturës që ka bërë shteti por dhe Bashkia ka kopetencë dhe kam dhe diçka tjetër për të shtuar,kryetarët e fshatrave duhet të jenë të ftuar në mbledhjet e këshillit në mënyrë që të trajtojnë çështjet në fshatrat e tyre të cilat ne i diskutojmë këtu.

Kryetari dhe Sekretari i Këshillit: Kryetarët e fshatrave janë të lajmëruar .

Këshilltari ,Miltiadh Prifti:- Me leje? Turizmi është zhvillimi i të ardhmes së vendit tonë,propozoj të kemi një komision për turizmin.

Kryetari Këshillit:-në rregull,është dakort këshilli?

Këshilli:-Dakort,e miratojmë.

Kryetari Këshillit:-Jeni dakort me rregulloren?

MIRATOHET VENDIMI NR 33 “MBI MIRATIMIN E RREGULLORES SË KËSHILLIT BASHKIAK HIMARË (me ndryshimin ku në komisionin e shërbimeve mbështetëse (arsimit,kultura,rinia,sporti futet dhe turizmi,me ndryshim në pikën 1 të nenit 9 dhe nenit 32 të rregullores) **ME 19 VOTA PRO**

Pika 2 e rendit të ditës

Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit “Për miratimin e komisioneve të përhershme të Këshillit Bashkiak për vitin 2023 dhe përbërja e tyre”.

Këshilltarja Afrovita Dhimojani:-Në bazë të rregullores kërkojmë 1/3 e komisioneve për sa na takojnë,dy grupe ,i ndajmë me konsensus.

Këshilltari Gjergji Iliadhi: (kryetar i komisionit) nga diskutimet në komision dolëm në kongluzion që ky projekvendim është në të mirë të komunitetit duke parë që Bashkia Himarë nga investimet nuk është në gjendje ta menaxhojë,të ardhurat,investimet .

Kryetari Këshillit:-Ujësjetllës Himarë po falimenton dhe është e drejtë ta marr Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Këshilltari Fuat Mati:- të plotësohen kërkesat tona.

Sqaron drejtori i ujësjetllës- kanalizime Himarë.

Debatojnë këshilltarët me njëri- tjetrin.

Kryetari Këshillit:-E hedhim në votim

Nuk miratohet pika 3 e rendit të ditës ,12 këshilltarë kundër dhe dy pro .

Sekretari

Elena Memushaj

